



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

Nr. _____ prot.

Durrës, më ____/____.2022

Lënda: Shkresë përcjellëse për prokurimin me objekt: **“BLERJE KIMIKATE”**

Z.Kasem Bejko
ADMINISTRATOR

Z.Denis GJONI
DREJTORI TREGTAR

NJËSISË SË PROKURIMIT

Këtu

Referuar shkreses me Nr. 7409/1 Prot Date 07.10. 2022 dhe Ligjit Nr. 162 te datës 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligj Nr. 182/2014; V.K.M -se Nr 285, date 19.05.2021 “Per rregullat e prokurimit publik, të ndryshuar” Bashkangjitur po ju dërgojmë dokumentacionin e praktikës me titull :

“BLERJE KIMIKATE” me këtë përmbajtje:

- 1- Deklarata e grupit qe s’kane konflikt interesi me këtë prokurim.
- 2- Proçes verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim si dhe perllogaritjen e fondit limit

Pikat 2 per te vazhduar me proçedurat e prokurimit do ti dorëzohen njësisë së prokurimit dhe në mënyrë elektronike.

Grupi i Specifikimeve Teknike:

Z. Ledio Lara
Z.Olsi Graceni
Znj.Enkelejda Basha

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“BLERJE KIMIKATE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kimikate për trajtimin e ujit 24962000-5

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti/enti kontraktor UKD sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*

b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar
Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, pika 2, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- c) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, si më poshtë

- a) 2 (dy) drejtues mjete ADR dhe
- b) 1 (nje) kimist

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, **për punonjës**in “Kimist” operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplomë
- Kontratë pune të vlefshme.
- Listpagesat e 3 muajve të fundit

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, **për punonjësit “Drejtues mjeti”** operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Leje drejtimi për mjete që kryejnë transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR)
- Kontratë pune të vlefshme.
- Certifikatë trajnimi për mjete që kryejnë transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR)
- Listpagesat e 3 muajve te fundit

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

Personi i punësuar kimist duhet që të vertetojë certifikatën e cilesisë së produktit,

2.4.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Duhet të ketë në pronësi ose me qera

- a) 2 mjete të autorizuar tip autobot, për transport kimikatesh, me kapacitet mbajtës 15-25 ton që kryejnë transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE.
- b) 2 kamion ku te pakten njeri prej tyre te kete kapacitet mbajtës 12-14 ton

-Gjithashtu për transportin e hipokloritit të natriumit mund të përoden depozita 1000 l IBC të vulosura, të pajisura me certifikatat e testimi dhe certifikatat ADR për secilën depozitë dhe nëpërputhje me dispozitat ADR sipas ligjit 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme” Për arsye se hipokloriti i natriumit klasifikohet si produkt ADR. Kamionat që transportojnë kimikate me këto depozita 1000 L duhet të jenë të pajisur me certifikate (ADR) për transport lëndesh të rrezikshme (Kimikate)

Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedura të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor (deklaratë nga administrator i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vëndndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).

Për të vertetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqes dokumentacionin e mëposhtëm:

Për mjetet që shënohen në regjistra publik duhet të paraqitet:

- a) dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit
- b) leje qarkullimi për “Transport lëndë të rrezikshme”,
- c) lejen e qarkullimit,

- d) certifikatën e kontrollit teknik,
- e) siguracionin e mjetit (të vlefshme),
- f) certificate konformiteti e cisternës rrugore dhe certifikatë e miratimit për mjetet që transportojnë disa mallrat e rrezikshme.
- g) Certifikatë për transport mallërash për të tretë dhe me qera brënda vëndit
- h) foto për mjetet e deklaruara ku të jenë të dukshme dhe target e mjetit.

Githashtu dhe për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet:

- a) Kontrata e qerese ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij
- c) lejen e qarkullimit,
- d) certifikatën e kontrollit teknik,
- e) siguracionin e mjetit (të vlefshme),
- f) certificate konformiteti e cisternës rrugore dhe certifikatë e miratimit për mjetet që transportojnë disa mallrat e rrezikshme.
- g) Certifikatë për transport mallërash për të tretë dhe me qera brënda vëndit
- h) foto për mjetet e deklaruara ku të jenë të dukshme dhe target e mjetit.

Mjetet duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekti këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- a) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publik duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësin e tyre.

Autoriteti kontraktor rezervon të drejten të verifikojë dhe kontrollojë në cdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet dhe pajisjet teknike të deklaruara.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ne cdo rast para publikimit të Njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit OE i kualifikuar i pari, ose në rast se kerkohen sqarime nga AK, duhet të paraqes të gjithë dokumentacionin e sipercituar për makinerite.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi me objektin e prokurimit për mallërat e kërkuar. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, Website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Autorizimi është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kerkohen në procedurë, na garanton se ofruesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësor të mallrave që kerkohen të blihen e që janë prodhuar në standartet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtperdrejt me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofrues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben AK për njohjen e mundësisë së OE se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të ligjit 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik" dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.4.2 Operatori ekonomik ofrues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që janë në përputhje me objektin e kontratës, certifikatat kerkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. si më poshtë:

1. ISO 9001:2015 ose ekuivalente në fushën e menaxhimit të cilësisë
2. ISO 14001:2015 ose ekuivalente në fushën e menaxhimit të mjedisit,
3. OHSAS 18001:2007 ose ekuivalente të njohura nga standartet shqiptare ISO 45001-2015 në fushën e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë,

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit)

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin të 36 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" **Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor** dhe neneve 40, pika 8, dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

-Cerifikata per sistemin e menaxhimit te cilesise **ISO 9001:2015** eshte e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet me natyren dhe vleren e kontrates, me qellim per te vertetuar dhe te garantoje realizimin ne kohe, me sukses dhe me cilesi sipas standarteve nderkombetare te objektit te kontrates.

-Cerifikata per sistemin e menaxhimit te mjedisit **ISO 14001:2015** e kerkuar nga AK garanton se OE ofrues do te sjelle produkte te cilat nuk demtojne mjedisin dhe nuk e ndotin ate dhe qe jane konform standarteve nderkombetare te cilesise. Kerkesa ne lidhje me keto certifikata eshte ne perputhje me nenin 44, te VKM Nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit public”, dhe nenin 79, te Nr 162, date 23.12.2020 “Per rregullat e prokurimit publik”.

-Cerifikata per sistemin e menaxhimit e shendetit dhe sigurisë në punë **OHSAS 18001:2007** ose ekuivalente te njohura nga standartet shqiptare **ISO 45001-2015** ka nje rendesi te vecante per kryerjen e kesaj kontrate.

2.4.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **certifikatën e prodhuesit** që vërteton konformitetin e produktit në prokurim me normat Europiane (EN901: 2013). Produkte kimike për tregëtimin e produkteve për trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor, konform normave europiane dhe shqiptare SSH/EN901: 2013 ose ekuivalente

Argumentim: Ky kriter eshte menduar per ti dhene sigurine AK qe OE ofrues do te paraqese mallra, te cilat permbushin kerkesat e specifikimeve teknike dhe jane ne perputhje me to. Ky kriteri eshte vendosur ne perputhje me piken 8, te nenit 40, te VKM Nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, dhe nenin 79, te ligjit Nr. 162 date 23.12.2021 “Per prokurimin publik”.

2.4.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë **Nr.Reach** të prodhuesit, ose vetedeklarim te prodhuesit i cili verteton se prodhuesi/t eshte/jane te regjistruar dhe te certifikuar për tregëtimin e hipokloritit të natriumit për trajtimin e ujit për konsum njerëzor në komunitetin European.

Argumentim: Ky kriter eshte menduar per ti dhene sigurine AK qe OE ofrues te paraqese mallra, te cilet permbushin kerkesat e specifikimet teknike dhe jane ne peputhje me to. Ky kriteri eshte vendosur ne peputhje me piken 8, te nenit 40, te VKM Nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

Qëllimi i Reach është përmirësimi i mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe mjedisit përmes identifikimit të mirë dhe të hershëm të vetive të brendëshme të substancave kimike. Rregullorja REACH i jep përgjegjësi më të madhe industrisë për të menaxhuar rreziqet nga kimikatet dhe për të siguruar informacion të sigurisë .

Shënim: Nëqoftëse subjekti është prodhues vendas atëhere ai duhet të zhatojë ligjin nr 9180, datë 17.07.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike “të regjistruar nga REACH dhe CLP.

2.4.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Licencave pra Ministrisë së Shëndetësisë për hipokloritin e natriumit ne rast se importohet jashte Republikës se Shqiperise.

Argumentim: Ky kriter eshte menduar er ti dhene sigurine AK qe OE ofrues do te paraqese mallra, te cilet permbushin kerkesat e specifikimeve teknike dhe ne peputhje me to. Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 5, te nenit 40, te VKM Nr.285, date 19.05.2021“Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

2.4.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesi certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik, për analizë kimike/fizike dhe toksikologjike për produktet që prokurohen (3 muajve të fundit) për hipokloritin e natriumit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit.

2.4.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra si më poshtë:

1. Hipoklorit Natriumi 12 – 15%

Per te permbushur kete kriter, OE ofrues duhet te paraqese nje deklarate ku jep: miratimin per kryerjen e analizave, te dhenat e kontaktit, ne menyre qe te kontaktohet dhe te jete i pranishem ne momentin e marrjes se mostres dhe dergimit te tyre prane laboratorit. Gjithashtu, duhe te deklaroje se merr persiper kryerjen e pageses se tarifes per kryerjen e analizave prane laboratorit.

Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Mos paraqitja e mostrave përbën kusht për s’kualifikim.

Argumentim: Ky kriter eshte hartuar, ne menyre qe vleresimi i mallrave te behet sa me i sakte dhe duke qene se mostrat e paraqitura nuk mund te vleresohen ne perberjen e tyre ne kushtet e punes ne AK vleresimi i ofertave do te mbeshtetet ne analizat laboratorike te bera nga institucione te akredituara. Kriteri i kerkuar ne lidhje me analizen e mostrave, eshte vendosur ne perputhje me piken 6/c te nenit 40 te VKM Nr 285. Date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik“.

2.4.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, si dhe të gjitha shpenzimet e parashikuara me kapitale DST.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Hipoklorit natriumi i lengshem (NaOCL)

Bazuar ne planin operacional dhe financiar per vitin 2023 sasia e parashikuar është 780 ton për 2 vjet, e cila e ndarë në përafersisht 390 për cdo vit dhe do të sherbej per Shoqerine Rajonale Durres dhe Njesite.

Nr	Pershkrimi	Njesia e matjes	Specifikimet
1	Gjendja	-	Leng I paster
2	Ngjyra	-	E verdhe

3	Densiteti 20°C	gr / ml	1.13 -1.28
4	Chloride (CL ₂)	% (m/m)	13 - 15
	<i>Substancattoksike</i>	mg/kg	<i>Limiett ne mg/kg tekloritaktiv</i>
5	Arsenik (As)	mg / kg	max 1,0
6	Cadmium (Cd)	mg / kg	max 2.5
7	Krom (Cr)	mg / kg	max 2.5
8	Merkur (Hg)	mg / kg	max 3.5
9	Nikel (Ni)	mg / kg	max 2.5
10	Plumb (Pb)	mg / kg	max 15
11	Antimon (Sb)	mg / kg	max 20
12	Selen (Se)	mg / kg	max 20

Malli duhet të dorëzohet pranë magazinave të klorit, të UK shaDurrës, në stacionet e klorinimit.

Afati i levrimit sipas kërkesave të Autoritetit kontraktor nga data e nënshkrimit të marrëveshjeskontrates.

Grupi i Specifikimeve Teknike:

Z. Ledio Lara
Z.Olsi Graceni
Znj.Enkelejda Basha